

OBVL, mesazh urimi për kryetarin e ri të PD, Lulzim Basha

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit Shqiptar (OBVL) i ka dërguar një mesazh urimi z.Lulzim Basha me rastin e zgjedhjes së tij në funksionin e lartë të Kryetarit të Partisë Demokratike. OBVL vlerëson

garën për leadershipin e ri të Partisë Demokratike, që evidentoi dukshëm ridimensionimin e vlerave të së djathtës. Duke evidentuar bashkëpunimin e ngushtë dhe përkujdesjen e madhe që z.Basha, si kryetar... (Faqe 2)



Veterani

ORGANIZATA E BASHKUAR E VETERANËVE TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR (OBVL)
GAZETË DYJAVORE. NR. 62 (293) 1-15 GUSHT 2013. ÇMIMI: 20 LEKË

Kryeredaktor: Halil RAMA

Adresa: Ministria e Mbrojtjes, Tiranë.

Email: veterani.obvl@yahoo.com

Niset me mision në Afganistan kontingjenti "Eagle-7"

Në Batalionin e Forcave Speciale në Zall-Herr u zhvillua më 24 korrik 2013, ceremonia e nisjes së kontingjentit "Eagle-7" mision "COMBAT" në Kandahar, Afganistan, i cili përbëhet nga 50 trupa të kompanisë së Aksioneve Speciale Ajrore. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin: shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi, komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, atashu ushtarak i SHBA në vendin tonë, Glenn Broën, gjeneralë, drejtorë dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, familjarë dhe të afërm të pjesëtarëve të kontingjentit "Eagle-7", etj. Pas fjalës së hapjes që mbajti komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, të pranishmit në ceremoni i përshëndeti shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunksi.

Duke iu drejtuar trupave paqeruajtëse, gjeneralmajor Gjunksi u shpreh: "Ndodhemi sot në një moment shumë solemn, ku është bërë traditë që nga ky shesh simbol i "burrërisë dhe trimërisë" t'ju përcjellim me nderime dhe respekt! Ju jeni përgatitur dhe do të niseni me mision në operacionin ushtarak ISAF të drejtuar nga NATO, në Afganistan. Pas gjashtë misionëve të tjera pararendëse, ju keni sot 6 herë më shumë përvojë nga rezultatet dhe mësimet e nxjerra. Ju me profesionalizmin e treguar në të gjitha misionet jeni krenaria e FARSH, ju do të shërbeni për 6 muajt e ardhshëm në operacionin e drejtuar nga NATO, në Afganistan, ku do të gjeni një përvojë të vyer dhe gjurmët më të mira të mundshme që kanë përcjellë kolegët dhe shokët tuaj, ushtarakë nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe atyre të vendeve partnere, veçanërisht SHBA".

(vijon në faqen 5)

RRITJE PENSIONESH PËR 595 MIJË PENSIONISTË

Të ardhurat minimale të pensionistit në qytet shkojnë 14 140 lekë



FAQE 3

Piramida ushqimore, çfarë dhe sa duhet të hamë?

Sa herë mund të tundoheni gjatë ditës kur bëhet fjalë për ushqimin? Dëshironi të hani dhe provoni gjithçka. Por ka një piramidë që na tregon se çfarë duhet të konsumojmë më tepër dhe sa duhet të hamë.

FAQE 8

Kanceri i prostatit, zgjidhja: vaji i ullirit dhe frutat e thata

FAQE 3

Përfundon misionin i Delegacionit Italian të Ekspertëve (DIE) në vendin tonë

FAQE 4

ZGJEDHJET EDHE NË VERI, ME LIGJE TË KOSOVËS

Ban Ki Moon: Marrëveshja në Veri mbetet sfida kryesore

FAQE 8

Dy vjet pa Agim Dylgjerin, njeriun që i sherbeu kulturës

FAQE 6

Mesazhi

Risi e liderit të ri demokrat është vendosja e një raporti të drejtë midis kontributit, meritës dhe përgjegjësisë OBVL, mesazh urimi për kryetarin e ri të PD, Lulzim Basha

Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit Shqiptar (OBVL) i ka dërguar një mesazh urimi z.Lulzim Basha me rastin e zgjedhjes së tij në funksionin e lartë të Kryetarit të Partisë Demokratike. OBVL vlerëson garën për leadershipin e ri të Partisë Demokratike, që evidentoi dukshëm ridimensionimin e vlerave të së djathtës.

Duke evidentuar bashkëpunimin e ngushtë dhe përkujdesjen e madhe që z.Basha, si kryetar i Bashkisë së Tiranës ka treguar ndaj veteranëve, kryesia e OBVL i shpreh atij urimet më të mira si bartës dhe njëherësh përçues dinjitozë i vlerave më të mira të shoqërisë shqiptare.

Kreu i OBVL, Rrahman Parllaku (gjeneral-lejtënant në pension, Hero i Popullit) shpreh bindjen se në këtë funksion të ri të lartë, Basha, do të bëjë realitet projektin demokratizues të PD-së. Kjo duket fare qartë në përcaktimin prej tij të përgjegjësisë së gjithsecilit demokrat, duke e vlerësuar një gjë të tillë në funksion të riorganizimit dhe konsolidimit tërësor të

strukturës së PD-së për të triumfuar në zgjedhjet e ardhshme. Duke e konsideruar këtë si përgjegjësi të të gjithë demokratëve, Basha e sheh fillimin e ri si një mundësi për t'u bashkuar me këtë familje të madhe, për të qenë bashkë në gëzime dhe në kohë të vështira.

Risi e liderit të ri demokrat është vendosja e një raporti të drejtë midis kontributit, meritës dhe përgjegjësisë. Kjo konsiston në bashkimin e gjithë demokratëve, edhe të atyre që në fushatën e fundit të zgjedhjeve parlamentare nuk dhanë çdo gjë, pa lejuar asnjë kundërshti dhe përçarje mes tyre.

Një maksimalizim i tillë i të gjitha resurseve vetëm para dy vjetësh i dha atij fitoren në garën për kryetarin e Bashkisë së Tiranës përballë kreut të mazhorancës aktuale. Po me këtë vizion ai ia doli ta shndërronte Tiranën në një kryeqytet të standardeve europiane.

Me Lulzim Bashën në krye të Bashkisë për Tiranën ka nisur një epokë e re. Kryeqyteti shqiptar ka tashmë një kryebashkiak të llojit të ri, të shumëkërkuar dhe votuar nga



qytetarët e tij për një bashki të re, një bashki me veshë për të dëgjuar qytetarët, një bashki me sy për të parë halllet e tyre, një bashki me zemër, e cila vlerëson çdo problem të qytetarëve si një problem të vetin. Dhe këtë Lulzim Basha ka dhënë prova se di ta bëjë

më mirë se askush tjetër. Parë nga ky këndvështrim, ai është përzgjedhja e duhur për kreun e ri të Partisë Demokratike. Karriera e tij e deritanishme politike dhe qeverisëse nuk ka nevojë të komentohet për nga sukseset dhe arritjet e shumta. Por ajo që qëndron në themelin e të gjithave dhe që premtion më shumë prej të gjithave është përkushtimi dhe idealizmi i tij, dashuria me të cilën ai merr përsipër dhe kryen punët publike dhe angazhimet për riorganizimin dhe kon-

solidimin e një opozite konstruktive përballë mazhorancës aktuale të një vote të deformuar. Duke njohur anët pozitive të traditës së PD-së, Basha synon shndërrimin e saj në një opozitë të fortë, konstruktive e institucionale, që ta sjellë atë në pushtet në zgjedhjet më të afërta. Projekti i shpalosur prej tij, që synon ta bëjë PD-në një forcë politike që t'i drejtohet qytetarit masiv dhe jo vetëm militantëve, duhet vlerësues si një projekt emancipues që jep shpresë.

Ambasadori i BE-së në Tiranë, Ettore Sequi uron Bashën për zgjedhjen si kryetar i PD

Statusi i vendit kandidat mund të arrihet deri në dhjetor

Ambasadori i BE-së në Tiranë, Ettore Sequi theksoi se është me rëndësi një transferim normal i kompetencave, ndërsa shtoi se statusi i vendit kandidat mund të arrihet deri në dhjetor. "Jam i bindur se në Europë, gjithkush është i bindur në rëndësinë e rolit që luan opozita në një sistem demokratik. Ne, kolegët europianë, shprehëm nga Brukseli dhe nga Tirana rëndësinë e përfundimit normal të procesit elektoral dhe një kalim normal të kompetencave. Kjo është shumë e rëndësishme gjithashtu edhe në lidhje me perspektivën drejt Bashkimit Europian. Kjo është gjithashtu shumë e rëndësishme edhe në kuadër të mundësisë për të marrë statusin e vendit kandidat. Ashtu siç kam rithënë, statusi i vendit kandidat është i arritshëm brenda dhjetorit. Kjo është ripërsëritur edhe nga Brukseli. Dje, presidentja lituaneze ka shprehur të njëjtë gjë në lidhje me statusin e Shqipërisë. Çka është e rëndësishme që të arrihet, është që të ekzistojnë përpjekje të përbashkëta nga të gjitha forcat politike. Bashkimi Europian padyshim është i gatshëm të asistojë në këtë proces, me kusht që procesi dhe reformat të vijojnë më tej", theksoi Sequi. Ambasadori i BE-së, teksa e ka përgëzuar Lulzim Bashën për zgjedhjen e tij në krye të PD-së, shprehu dhe një herë rëndësinë e një tranzicioni normal të pushtetit. Sequi vuri theksin tek



përfundimi në kohë i procesit të çertifikimit të zgjedhjeve, në mënyrë që të vijohet me përmbushjen e detyrimeve të tjera, siç tha ai, pasi mundësitë për marrjen e statusit kandidat për në BE në dhjetor janë të mëdha. "Më lejoni të them se erdha këtu për të uruar zotin Basha, në zgjedhjen e tij si kreu i Partisë Demokratike. Doja ta uroja personalisht dhe të shprehja urimet e mia për një punë të mirë. Tani zoti Basha ju bëri një pasqyrim të Partisë Demokratike, ndërsa unë do të bëja një përshkrim të Bashkimit Europian. Do të doja të thoja gjithashtu se ne besojmë që në mënyrë që të bëjmë progres në rrugën drejt Bashkimit Europian, dy gjëra janë të rëndësishme. Qeverisje të fortë që mirëfunksionon dhe europiane, gjithashtu edhe një opozitë të fortë, moderne dhe që funksionon mirë", theksoi Sequi.

- Zoti Sequi, ç'mund të thoni për kontestimet e Partisë Demokratike?
Besoj se ju keni liderin këtu dhe mund të pyesni kryetarin në lidhje me pozicionin e Partisë Demokratike.

- Zoti Basha, me formimin e Grupit parlamentar do të prisni të ngrihen strukturat e tjera të Partisë Demokratike apo kjo do të ndodhë më pas?

Mendoj se mesazhet e sotme në raport me takimin me përfaqësuesin më të lartë të Bashkimit Europian në vend, ambasadorin Sequi, janë të qarta dhe mëse të mjaftueshme. Për çdo çështje tjetër do të kemi komunikime të tjera.

- Zoti Sequi, përsa i përket çertifikimit të zgjedhjeve, keni ndonjë koment, pasi po vazhdon të vonojë procesi, pavarësisht se kemi një tërheqje të Partisë Socialiste për Qarkun e Lezhës.

Ashtu siç e kam thënë, dhe kolegët e tjerë e kanë thënë po ashtu, për shembull, kolegu italian, ambasadori Galliani, është e rëndësishme të kemi një përmbyllje në kohë, normale të procesit elektoral. Ne jemi në stinën e verës, vera nuk do të zgjasë shumë, ndonjëherë është edhe nxehtë dhe nuk kemi shumë kohë përpara raportit të progresit në tetor dhe takimit të Këshillit të Europës në dhjetor. Pra, çfarë mund të

PD do të bëjë gjithçka që Shqipëria të marrë statusin kandidat

Kryetari i PD, Lulzim Basha ka siguruar ambasadorin Sequi dhe gjithë partnerët europianë për vendosmërinë e PD për të vijuar rrugën e saj si forca kryesore europianizuese dhe e vokacionit perëndimor të shqiptarëve. Zoti Basha tha se PD do të japë të gjithë kontributin e saj që Shqipëria të marrë sa më parë statusin e vendit kandidat, i cili u pengua nga PS me mosvotimin e 3 ligjeve. "Partia Demokratike e Shqipërisë ka qenë dhe mbetet forca kryesore europianizuese dhe e vokacionit perëndimor të shqiptarëve. Është forca që ka nisur procesin e integritimit europian dhe euroatlantik të Shqipërisë, ka arritur disa faza shumë të rëndësishme si nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, aplikimi për anëtarësim të plotë, rekomandimi pozitiv nga Komisioni Europian, për statusin kandidat, i cili fatkeqësisht u bllokua nga mosvotimi në kohë i tri ligjeve nga opozita sot në mazhorancë. PD është forca politike që ka bërë të mundur përmes reformave, ftesën për NATO dhe anëtarësimin e plotë në NATO dhe do të jetë forca politike që do të japë gjithçka sot në opozitë dhe nesër në mazhorancë për vazhdimin e rrugëtimit tonë për një destinacionin final, që është në fakt edhe një nga porositet gjenetike të Partisë Demokratike "Ta bëjmë Shqipërinë si gjithë Europën", theksoi Basha. Në këtë kuadër, kryetari demokrat siguroi ambasadorin Sequi për përpjekjet e vazhdueshme të Partisë Demokratike sot, por edhe me fillimin e sezonit të ri parlamentar për t'u angazhuar fuqishëm, në mënyrë që rrugëtimi, drejt marrjes së statusit kandidat dhe hapave të tjerë, të jetë sa më i shpejtë, duke vazhduar rrugëtimin tonë mbi trashëgiminë që ka deri tani.

ndihmojë për një përfundim normal të procesit elektoral është e rëndësishme.

- Zoti Sequi, ju kishit përpara kryetarin e ri të Partisë Demokratike, ndërkohë keni Partinë Demokratike si forcë opozitare tashmë dhe jo si forcë mazhoritare. Si e shikoni ju personalisht këtë situatë dhe Brukseli, patjetër, në këtë konfiguracion të ri politik në Shqipëri?

Opinionin nga Brukseli është

gjithashtu shumë miqësor ndaj Shqipërisë. Konfigurimi politik i vendit është padyshim rezultat i dëshirës së njerëzve dhe jo dëshirës së Brukselit. Brukseli është mjaft i interesuar për procesin e reformave, i cili do të bënte të suksesshme rrugën e integritimit europian.

- Zoti Sequi, si e vlerësoni garën e PD-së dhe liderin e ri?

Pra, siç e di dhe unë, siç e dini edhe ju, ne kemi një kryetar të ri të PD.

AKTUALITET

Të ardhurat minimale të pensionistit në qytet shkojnë 14 140 lekë

Rritje pensionesh për 595 mijë pensionistë

Qeveria Berisha, për të tetin vit radhazi, do të gëzojë familjet e 595 mijë pensionistëve, pasi nga data 1 gusht pensionet e tyre do të pësojnë rritje. Në mbledhjen e fundit Këshilli i Ministrave ka marrë vendimin për rritjen e pensioneve, pensioni më i ulët në qytet shkon 12 024 lekë dhe 24 048 lekë, pra sa dyfishi i pensionit minimal. Ndërsa të ardhurat minimale të pensionistit në qytet shkojnë 14 140 lekë. Këshilli i Ministrave ka nxjerrë një vendim për rritjen e pensioneve dhe përfitimeve të tjera që rrjedhin nga ligjet e ndryshme të sigurimeve shoqërore. Ky vendim tashmë është botuar edhe në Fletoren Zyrtare dhe menjëherë ka nisur puna për të përcaktuar mënyrën se si do të bëhet ndarja e rritjes, për të gjithë pensionistët përfitues, sipas kategorive përkatëse. Sipas të dhënave, qendrat paguese janë përgatitur me gjithë informacionin e nevojshëm për të përgatitur të gjitha procedurat, udhëzimet e nevojshme dhe sistemet informatike për të vazhduar dhe për të emetuar nga 1 gushti i 2013 me rritje. Efektet financiare të vendimit shtrihen nga 1 gushti pra, dhe parashikohet që të përfitojnë rreth 595 mijë përfitues me efekt 1,578 miliardë lekë të ndara me kategori specifike, pensionet e shtetit, fshatit dhe trajtimet e veçanta financiare dhe pensionet e posaçme që caktohen me vendime të veçanta, procedurat që i bën konkretisht ISSH-ja. Pensioni rritet 4 për qind për qytetet dhe 5 për fshatin. Në vijim të politikës së shtetit për ngushtimin e diferencave midis pensioneve të shtetit dhe atyre të fshatit dhe për të arritur në një periudhë kohore që këto të barazohen, me ritme më të shpejta, janë rritur blloku i pensioneve që rrjedhin nga puna e ish-kooperativave bujqësore dhe këto në i quajmë pensione fshati. Pensionet e qytetit që rriten me 4 për qind rriten rreth 450 lekë në muaj. Rritjen bashkë me pensionin kështu muajor të muajit gusht pensionistët do ta marrin nga 1 gushti. Pensioni më i ulët në qytet shkon 12 024 lekë dhe 24 048 lekë. Pra, sa dyfishi. Ndërsa të ardhurat minimale të pensionistit në qytet përveç pensionit të rritur përfiton edhe të ardhura që rrjedhin nga përmirësimi i nivelit të jetesës së pensionistit dhe të ardhurat bazë shkojnë 14 140 lekë. ISSH ka siguruar fondet e nevojshme dhe po punohet për pasqyrimin në dokumentet e pagesave se sa ato janë të shpërndara në të gjithë territorin e Shqipërisë, atje ku jetojnë dhe punojnë pensionistët. ISSH në bashkëpunim me Postën Shqiptare ka filluar zbatimin në praktikë të rritjes reale të pensioneve dhe rritja do të bëhet për 595 mijë pensionistë.

Ligji për pensionet

Pensionet e përgjithshme të qytetit, ato të invaliditetit dhe familjare, si dhe ato të kategorive të veçanta si ushtarakë, pilotë, rriten me 4 për qind. Sipas vendimit të qeverisë, këto pensione nga 1 gushti nuk caktohen më pak se 8233 lekë në muaj, por nuk duhet të kalojnë 12 024 lekë në muaj. Shtuar këtu edhe pjesën e kompensimit të energjisë, lëndëve djegëse, të ardhurave të ulëta apo çmimit të bukës, vlera e përfitimit final rritet. Nga përlllogaritja rezultojnë pas rritjes së aplikuar nga qeveria pensionet maksimale të pleqërisë dhe ato të parakohshme për vjetërsi shërbimi arrijnë në 13 674 lekë në muaj, pensionet e invaliditetit dhe ato familjare deri 13 174 lekë në muaj dhe pensionet minimale të pleqësisë dhe të invaliditetit deri 8 923 lekë në muaj. Duke vijuar politikën e barazimit të përfitimeve me qytetin, edhe këtë vit qeveria ka rritur me një për qind më shumë pensionet në fshat, pra rritja për këtë kategori është 5 për qind. Vendimi përcakton se edhe pensionistët e fshatit përfitojnë pjesë të kompensimit për të ardhurat minimale, si dhe atë që lidhet me energjinë elektrike. Pas kësaj përlllogaritjeje, kjo kategori ka të tjera limite për të ardhurat maksimale dhe minimale nga pensioni. "Të ardhurat nuk mund të jenë më



të ulëta se 9123 lekë në muaj dhe më të larta se 12 224 lekë në muaj", thuhet në vendim.

Të ardhurat minimale

Pas datës 1 gusht, të ardhurat minimale të personave, që përfitojnë pensionet e plota të pleqërisë dhe pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi, përjashtuar ato të caktuara sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të Ligjit "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" nuk mund të jenë më të

ulëta se 14 174 (katërmëdhjetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë në muaj. Gjithashtu të ardhurat minimale të personave që përfitojnë nga pensionet e caktuara dhe kompensime për çmimin e energjisë elektrike dhe për të ardhurat nuk mund të jenë më të ulëta se 9 123 (nëntë mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë në muaj dhe më të larta se 12 224 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e katër) lekë në muaj. Sipas vendimit efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, në shumën 1 411 (një mijë e


katërqind e njëmbëdhjetë) milionë lekë, të përballohen nga fondet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Kontingjencës, të parashikuara në buxhetin e shtetit të vitit 2013 dhe ndahen për mbulimin e pagesave të pensioneve, në shumën 1 395 (një mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) milionë lekë, për procedurat teknike të zbatimit të këtij vendimi dhe për pagesën e komisioneve të shërbimit të pagesave të pensioneve nga Posta Shqiptare, sh.a., në shumën 16 (gjashtëmbëdhjetë) milionë lekë.

Kanceri i prostatit, zgjidhja: vaji i ullirit dhe frutat e thata

Meshkujt me kancer në prostat mund ta përballojnë më mirë këtë sëmundje, nëse ata bashkëngjisin në mënyrën e të ushqyerit të tyre, vajë ulliri, fruta të thata dhe avokado, si të dhe reduktojnë e të kufizojë yndyrat shtazore dhe karbohidratet, sipas një studimi të ri.

Nga studimi rezultoi se të gjithë ata pacientë që kanë zëvendësuar 10% të yndyrave shtazore dhe të karbohidratet me yndyrna të shëndetshme të përmendura më lart, kanë 29% më pak gjasa të vdesin nga përhapja e kancerit, krahasuar me ata që nuk e kanë bërë këtë ndryshim të shëndetshme.

Kanë 26% më pak mundësi të vdesin nga çfarëdo lloj shkaku tjetër. Për të arritur dikush një rezultat të tillë, nuk duhet të bëjë ndryshime dramatike: qoftë dhe një lugë supe po të hanë më shumë çdo ditë, do të zvogëlohet me 29% rreziku i vdekjes nga kanceri dhe me 13% nga çdo lloj shkaku tjetër, raportojnë studiues amerikanë në revistën shkencore "JAMA Inter-



nal Medicine". Studimi u realizua në më shumë se 4.600 meshkuj, pacient me kancer lokal të prostatit, të cilët mjekët i ndoqën me vëmendje shumë të madhe për më shumë se tetë vjet. Ndërkohë, 1,064 prej tyre vdiqën, me 31% duke humbur jetën e tyre nga sëmundje të zëmrës, 21% nga sëmundjet e kancerit të prostatës dhe më pak se 21% e kancerëve të tjera. Rezultati përfundimtar ishte se "konsumimi i vajit t ullirit,

apo yndyrnave të shëndetshme mund të ushtroj aktivitet mbrojtës", deklaroi mjekja dhe studiuesja Dr Erin Ritsman nga Departamenti i Epidemiologjisë & Biostatistikës, Universiteti i Kalifornisë, San Francisco.

Në një koment që shoqëron studimin e ri, Dr Steven Friedland, Profesor i Kirurgjisë, Departamenti i Urologjisë, Universiteti i Dukës, vë në dukje se "Kjo është e dokumen-

Meshkujt me kancer në prostat mund ta përballojnë më mirë këtë sëmundje, nëse ata bashkëngjisin në mënyrën e të ushqyerit të tyre, vajë ulliri, fruta të thata dhe avokado, si të dhe reduktojnë e të kufizojë yndyrat shtazore dhe karbohidratet, sipas një studimi të ri

tuar mirë se trashja rrit rrezikun e vdekjes nga kanceri i prostatës. "Ai vazhdon të theksojë: "Studimi i ri ofron disa dëshmi që reduktimi i yndyrnave të ngopura dhe karbohidratet dhe zëvendësimin e tyre me yndyrna të shëndetshme mund të zvogëlojë këtë rrezik."

Përfundon misioni i Delegacionit Italian të Ekspertëve (DIE) në vendin tonë

Ministri Imami: "Tashmë ne kemi një Shqipëri më stabile, shumë më të qëndrueshme dhe jemi të gjithë të lumtur për këtë. Ky është një kontribut i qytetarëve shqiptarë, është kontribut i të gjithë neve, padyshim edhe i miqve dhe bashkëpunëtorëve tanë, ku Italia ka një rol të veçantë. Vendi ynë tashmë është më i sigurt se asnjëherë, ai është anëtar i Aleancës më të madhe në botë, NATO".

Në rezidencën e ambasadorit të Italisë në Tiranë, më 26 korrik 2013 u zhvillua ceremonia e përmbylljes së aktivitetit 16-vjeçar të Delegacionit Italian të Ekspertëve në Shqipëri (DIE). Në këtë ceremoni morën pjesë: ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Gjünkshi, zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj Arta Musaraj, gjeneral dhe ushtarakë të tjerë të lartë të Forcave të Armatosura, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, etj. Ndërsa nga pala italiane ishin të pranishëm: shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Mbrojtjes italiane, admiral Luigi Binelli Mantelli, ambasadori i Italisë në Shqipëri, Massimo Gaiani, efektivë të Delegacionit Italian të Ekspertëve në Tiranë, etj.

Ceremoninë e hapi ambasadori i Republikës së Italisë në Shqipëri, Massimo Gaiani, ndërsa më pas ka përshëndetur shefi i Shtabit të Përgjithshëm i Mbrojtjes italiane, admiral Luigi Binelli Mantelli. Admiral Mantelli vlerësoi me nota shumë pozitive marrëdhëniet midis dy vendeve dhe ushtrive tona, lidhjet me traditat dhe historinë, duke veçuar sidomos figurën e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu, poetin dhe shkrimtarin Jeronim De Rada, etj. Admiral Mantelli është

të ndalur sidomos në rolin dhe kontributin e vyer që ka dhënë në këto 16 vjet DIE në Shqipëri, për punën dhe kontributin e drejtuesve dhe efektivave të saj, për bashkëpunimin e frytshëm të tyre me drejtuesit dhe ushtarakët e FA shqiptarë, duke theksuar në fund se: "me kënaqësi mund të themi se tashmë ky mision u përmbysh me sukses të plotë".

Duke marrë fjalën në ceremoninë e përfundimit të misionit të DIE në Shqipëri, ministri i Mbrojtjes Imami u shpreh se: "jemi në një moment ceremonial të rëndësishëm, mbyllim një fazë të bashkëpunimit midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura të Italisë". Me këtë rast, z. Imami ka falënderuar DIE që për gati 16 vjet ka ushtruar veprimtarinë e saj këtu në Shqipëri dhe ka qenë një bashkudhëtare në rrugën tonë drejt anëtarësimit në NATO dhe në integrimin e plotë të Forcave tona të Armatosura në këtë Aleancë. Ai ka falënderuar gjithashtu drejtuesit e këtij misioni ndër vite dhe veçanërisht komandant Pellegrinin, i cili kryeson aktualisht këtë delegacion.

Duke u ndalur në momentin e përfundimit të këtij misioni, ministri Imami u shpreh: "Tashmë ne kemi një Shqipëri më stabile, shumë më të qëndrueshme dhe jemi të gjithë të lumtur



për këtë. Ky është një kontribut i qytetarëve shqiptarë, është kontribut i të gjithë neve, padyshim edhe i miqve dhe bashkëpunëtorëve tanë, ku Italia ka një rol të veçantë. Vendi ynë tashmë është më i sigurt se asnjëherë, ai është anëtar i Aleancës më të madhe në botë, NATO". Më tej, ministri Imami ka nënvizuar ndihmën dhe kontributin e dhënë ndër vite nga misioni i DIE, që nga ato më të domosdoshmet dhe urgjentet dhe deri tek ndihma më të profilizuara dhe të shtrira në të gjitha fushat e mbrojtjes. "Edhe në të ardhmen do të vijojë një bashkëpunim akoma më i thellë, më i rëndësishëm dhe më strategjik midis dy ushtrive tona, si dy ushtri që qëndrojnë në barazi dhe dinjitet të plotë në NATO", - ka shprehur bindjen e tij, ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami.

Në fund të ceremonisë, ministri i Mbrojtjes Imami u dorëzoi medalje "Për Shërbime të Shquara" personelit të DIE për kontributin e çmuar të dhënë në mbështetjen teknike, stërvitore dhe organizative të planeve të

zhvillimit të FA shqiptare dhe përshatjen e tyre me standardet e NATO. Ndërsa komandanti i DIE, kapiten i rangut të parë, Massimo Pellegrini i dorëzoi ministrit Imami një dhuratë në formë pllakate në kujtim të misionit prej 16 vjetësh bashkëpunimi dhe mbështetjeje nga mbrojtja italiane nëpërmjet DIE në Shqipëri.

Delegacioni Italian i Ekspertëve u krijua më 28 gusht të vitit 1997, pas firmosjes së një protokollit të posaçëm ministerial dypalësh, si shprehje dhe përgjigje e qeverisë italiane ndaj nevojave për mbështetje të Shqipërisë dhe në veçanti të Forcave të saj të Armatosura, të cilat në atë kohë kalonin një gjendje të vështirë shkaktuar nga rënia e regjimit komunist në vitin 1991. Delegacioni në organikën e tij ushtarakë gjithëarmëshë, mori detyrën për të mbështetur FA shqiptare në procesin e përshatjes të strukturave të saj me standardet perëndimore dhe me modelin e NATO.

DIE si element koordinues i mbrojtjes italiane në Shqipëri ka

qenë një model konkret dhe efikas bashkëpunimi midis FA të dy vendeve, duke i dhënë jetë një forme bashkëpunimi direkte e cila nga asistencë e mirëfilltë, u transformua gjatë viteve në një organizëm bashkëpunimi që përfshiu të gjithë personelin e FA shqiptare, në sektorë dhe shërbime të ndryshme si ai i shëndetësisë ushtarake, i shërbimit meteorologjik, kërkim-shpëtimin, xhenios, për Forcat Detare, Forcat Ajrore, mbrojtjen civile, etj. Ky bashkëpunim ka mundësuar deri edhe në pjesëmarrjen e ushtarakëve shqiptarë në misione të shumta të tipit Peace Support Operations (PSO), të cilat janë kurorëzuar në janar 2008, me inkuadrimin e një kompanie të FA shqiptare në Afganistan dhe me hyrjen e Shqipërisë në NATO në vitin 2009. Përfundimi i misionit të DIE në Shqipëri përbën një moment domethënës të progresit, të zhvillimit të mbrojtjes shqiptare në NATO dhe gjithashtu të një evolimi pozitiv të marrëdhënieve dypalëshe italo-shqiptare.

Ministri i Mbrojtjes Imami priti shefin e Shtabit të Mbrojtjes së Italisë

Më 26 korrik 2013, ministri i Mbrojtjes, z. Arben Imami, priti në një takim të veçantë shefin e Shtabit të Mbrojtjes të Republikës së Italisë, admiral Luigi Binelli Mantelli, i cili në krye të një delegacioni të nivelit të lartë ushtarak italian po bën një vizitë zyrtare në vendin tonë. Qëllimi i kësaj vizite është forcimi i bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis dy vendeve tona fqinje, si edhe pjesëmarrja në ceremoninë e mbylljes me sukses të plotë të misionit të Delegacionit Italian të Ekspertëve në vendin tonë. Në këtë takim ishe të pranishëm edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Xhemal Gjünkshi dhe ambasadori i Republikës së Italisë në Tiranë, z. Massimo Gaiani.

Ministri i Mbrojtjes Imami, pasi i uroi mirëseardhjen në Tiranë, admiral Luigi Binelli Mantellit dhe delegacionit të lartë ushtarak italian, ka vlerësuar nivelin e lartë të marrëdhënieve midis dy vendeve tona dhe ka theksuar se jemi të vendosur



të vazhdojmë në këtë rrugë duke ruajtur dimensionin europian. "Këto 20 vjet, ka nënvizuar Imami, Shqipëria ka bërë gjithçka për paqen, duke krijuar marrëdhënie shumë të mira me vendet anëtare të NATO dhe vendet partnere. Edhe pse tranzicioni ka qenë i vështirë ne vendosëm të bëjmë një ndryshim për Forcat e Armatosura, duke i dhënë një pamje të re atyre si dhe duke i modernizuar ato". Në muajin shtator, ka nënvizuar z. Imami, do të jemi në opozitë, duke vazhduar kontributin tonë për progresin e mëtejshëm të vendit.

Vend të veçantë në këtë takim

iu kushtua bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes, bashkëpunimi i cili u fuqizua sidomos me vendosjen në vendin tonë të Delegacionit Italian të Ekspertëve në vitin 1997. Ministri Imami ka vlerësuar ndihmën dhe mbështetjen e vazhdueshme të Forcave të Armatosura të Italisë për FA shqiptare në rrugën e tyre drejt integritit të plotë në strukturat e NATO, si dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që kemi pasur me Forcat e Armatosura italiane në Afganistan.

Më tej, dy bashkëbiseduesit kanë folur dhe diskutuar për situatën në rajonin tonë, marrëdhëniet dhe bashkëpunimin rajonal, sigurinë dhe stabilitetin, etj. Në këtë kontekst, ministri Imami ka theksuar se Shqipëria ka dhënë dhe do të vijojë të jap ndihmesën e saj për konsolidimin e shtetit të Kosovës dhe anëtarësimin e saj në institucionet dhe organizmat ndërkombëtare, si dhe mbështetjen marrëveshjen e fundit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë.

Nga ana e tij, shefi i Shtabit të Mbrojtjes së Republikës së Italisë, admiral Luigi Binelli Mantelli, falënderoi ministrin e Mbrojtjes Imami për pritjen që i rezervoi, si dhe vlerësoi arritjet e shënuara në rrugën e reformimit dhe modernizimit të FA Shqiptare. Admiral Mantelli ka nënvizuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy vendeve tona, duke u ndalur sidomos në bashkëpunimin në operacionet e ISAF në Afganistan dhe në ato të Bashkimit Europian në të cilat kemi marrë pjesë. Admiral Luigi Binelli Mantelli ka nënvizuar veçanërisht kontributin e dhënë nga Delegacioni Italian i Ekspertëve, misioni i cili për 16 vjet rresht ka shërbyer këtu në Shqipëri. Ky mision ka qenë shumë i rëndësishëm sepse jo vetëm i ka shërbyer forcimit dhe konsolidimit të FA shqiptare, por edhe forcimit të mëtejshëm të marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Ai është shprehur gjithashtu se Italia dhe FA italiane do të vazhdojnë të mbështesin edhe në të ardhmen

Shqipërinë dhe Forcat e saj të Armatosura në rrugën drejt integritit të plotë në strukturat Euroatlantike.

Më herët, shefi i Shtabit të Mbrojtjes së Republikës së Italisë, admiral Luigi Binelli Mantelli, është pritur me Truproje Nderi nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjünkshi. Me këtë rast, për delegacionin e lartë ushtarak italian nga drejtori i Drejtorisë së Planifikimit dhe Monitorimit të Mbrojtjes, kolonel Nazmi Cahani, u bë një prezantim i shkurtër për rrugën e transformimit dhe të modernizimit, anëtarësimin dhe integritin të plotë në NATO të Forcave të Armatosura shqiptare.

Niset me mision në Afganistan kontingjenti "Eagle-7"

(vijon nga faqja 1)

Më tej, gjeneralmajor Gjunkshi, duke vlerësuar këtë mision si një obligim të madh, më madhorin obligim të ushtarakut shqiptar, u ka kërkuar paqeruajtësve të ruajnë nivelin e arritur deri më sot dhe të punojnë për t'i çuar ato më lartë. "Ju jeni ambasadorë të Shqipërisë në Afganistanin e largët. Ju jeni figura dhe personifikimi i atdheut, ju jeni mbajtësit më dinjitozë të flamurit tonë kombëtar. Ju jeni shokët e komandant Feti Voglit, dëshmorit tonë që i shërbeu misionit deri në vetëmohim. Për të gjitha këto arsye, ju duhet të jeni shumëfish të kujdesshëm dhe po kaq dinjitozë", - është shprehur gjeneralmajor Gjunkshi. Në përfundim të ceremonisë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA, gjeneralmajor Xhemal Gjunkshi, i dorëzoi flamurin kombëtar, komandantit të kontingjentit "Eagle-7", major Pali Dakolli.

Kontingjenti "Eagle-7" i Batalionit të Forcave Speciale ka zhvilluar stërvitje të përbashkëta "Combinet", "Joint" dhe "Exchange", me Forcat Speciale Amerikane në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencës. Stërvitja paradislokuete e këtij kontingjenti është zhvilluar 14 javë nga instruktorë të Batalionit të Forcave Speciale në rajonin e Zall-Herrit. Efektivat janë të kompanisë së Aksioneve Speciale Ajrore, e cila shkon në këtë mision për të dytën herë. Gjatë trajnimit, kontingjenti "Eagle-7" iu nënshtrua Kursit të Avancuar të Operacioneve Speciale. Efektivi është trajnuar gjithashtu për çështje të operacionalitetit, zbulimit, ndërlidhjes, xhenios, shëndetësisë, armatimit, etj. Ai është inspektuar dhe monitoruar nga ekiye të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe Forcës Tokësore. Batalioni i Forcave Speciale ka kontribuar në misione në Bosnje dhe Hercegovinë, Irak, Afganistan, Çad, etj.



Prezantohet raporti për "Vetëvlerësimin Gjnor në Forcat e Armatosura"

Zëvendësministrja e Mbrojtjes Musaraj: "Me përmbushjen e këtij procesi, Shqipëria bëhet vendi i dytë anëtar i NATO pas Holandës, që realizon suksesshëm këtë arritje. Kjo është një dëshmi më shumë e maturisë dhe e kompetencës së fituar, e Mbrojtjes Shqiptare si anëtare e denjë e NATO dhe e standardeve të arritura prej saj përmes një menaxhimi efektiv dhe eficient të resurseve të veta".



Në përfundim të projektit studimor për "Vetëvlerësimin Gjnor në FA", më 24 korrik 2013, në Qendrën e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes, u zhvillua konferenca për prezantimin dhe dorëzimin e raportit final, përgatitur nga grupi që punoi për mbledhjen dhe përpunimin e informacionit. Në këtë takim ishte e pranishme zëvendësministrja e Mbrojtjes, prof. dr. Arta Musaraj, drejtorë dhe ushtarakë të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë. Pjesëmarrës në këtë takim ishin gjithashtu partnerë dhe mbështetësit kryesorë të këtij projekti, përfaqësues të UN Eomen dhe Qendrës për Kontrollin Demokratik në Forcat e Armatosura (DCAF), në Gjenevë.

Takimi përmblyllës i këtij projekti synon të paraqesë në mënyrë të përmbledhur gjetjet dhe rekomandimet për ecurinë e procesit të

integritimit dhe barazisë gjinore në Forcat e Armatosura, mbështetur në një plan konkret veprimi për të ardhmen.

Raportin studimor për "Vetëvlerësimin Gjnor në Forcat e Armatosura" e ka prezantuar znj. Mirela Rrumbullaku, kryetare e grupit të punës.

Në fjalën e saj përshëndetëse, zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Arta Musaraj theksoi: "Çështjet e barazisë gjinore, gjithnjë e më shumë po kalojnë në të qenë projekt diskutimi, në të bërit element identifikues i strategjive afatgjate dhe largpamëse të menaxhimit të burimeve njerëzore kombëtare. Në rastin e Shqipërisë kjo është një arritje e madhe. Në të njëjtën kohë është një tregues ndryshimi esencial, pasi nga një çështje e të drejtave të njeriut, barazia gjinore bëhet indikator i nivelit të maturisë së shoqërisë dhe proceseve evolutive të saj, si dimension civilizimi

dhe zhvillimi".

Më tej, në fjalën e saj znj. Musaraj u shpreh se mbrojtja shqiptare është sot e përmbushur në objektivat e veta të barazisë gjinore të krahasuar me sisteme analoge në rajon me dimensionet e veta të prezencës së grave në të dhe kjo jo vetëm horizontalisht, por edhe vertikalisht referuar avancimit në karrierën e tyre. Kjo sepse nga ne është parë jo si një sensibilitet i shoqërisë, por në një optikë më largpamëse, atë të menaxhimit cilësor të burimeve njerëzore kombëtare. Ajo çfarë mund të themi sot për çështjet e barazisë gjinore në mbrojtjen shqiptare është se objektivi i vendosur në lidhje me prezencën e grave është tejkaluar dhe kemi indikator të mirë cilësor në këtë drejtim. Nga përpjesa e grave në FA shqiptare 21% e tyre janë oficerë dhe 19% nënoficerë, 10% ushtarë profesionistë duke kapur një përqindje 26% të totalit të burimeve njerëzore të

mbrojtjes shqiptare. Janë bërë përparime të rëndësishme në përfaqësimin e femrave në funksione treguese vendimmarrëse, nga 9% që ka qenë në vitin 2011, tani kemi 15% femra në këto funksione. Mund të themi me krenari se kemi një përfaqësim të denjë të tyre në misione dhe në përfaqësitë tona ushtarake jashtë vendit. "Me përmbushjen e këtij procesi, Shqipëria bëhet vendi i dytë anëtar i NATO pas Holandës, që realizon suksesshëm këtë arritje. Kjo është një dëshmi më shumë e maturisë dhe e kompetencës së fituar, e Mbrojtjes Shqiptare si anëtare e denjë e NATO dhe e standardeve të arritura prej saj përmes një menaxhimi efektiv dhe eficient të resurseve të veta", - ka nënvizuar, znj. Musaraj.

Duke përgëzuar strukturat e brendshme të FA të përfshira në këtë proces, zëvendësministrja e Mbrojtjes Musaraj në fund të fjalës së saj vlerësoi partnerët ndërkombehtarë për kontributin e tyre në përmbushjen e këtij procesi, duke e konsideruar atë një fazë të parë të realizuar suksesshëm dhe bazë e qëndrueshme për menaxhimin e suksesshëm të FA shqiptare.

Konferencën për prezantimin e raportit për "Vetëvlerësimin Gjnor në Forcat e Armatosura" e përshëndeti znj. Anja Ebnother, zëvendësdrejtoresh e Përgjithshme e DCAF, si dhe znj. Estela Bulku, koordinatorë Kombëtare e UN Eomen në Shqipëri, të cilat vlerësuan arritjet e shënuara nga Ministria e Mbrojtjes dhe FA shqiptare, si dhe punën e kryer nga grupi i punës për realizimin e projektit studimor për "Vetëvlerësimin Gjnor në Forcat e Armatosura", projekt i cili, sipas tyre, do të shërbejë si bazë për diskutime dhe planifikime të mëtejshme politikash në këtë fushë.

Në përfundim të këtij aktiviteti, zëvendësministrja e Mbrojtjes, znj. Arta Musaraj, në shenjë falënderi-

mi dhe mirënjohjeje për mbështetësit kryesorë të këtij projekti, ka dhuruar tre dhurata simbolike për znj. Estela Bulku, znj. Anja Ebnother dhe znj. Aiko Holvikivi, akorduar nga Ministria e Mbrojtjes. Ndërsa nga znj. Anja Ebnother, zëvendësdrejtoresh e Përgjithshme e DCAF, u ndanë certifikata të akorduara për grupin e punës që ka mundur realizimin me sukses të këtij projekti.

Projektin studimor për "Vetëvlerësimin Gjnor në Forcat e Armatosura" është realizuar me mbështetjen dhe bashkëpunimin e UN Eomen dhe "Qendrës për Kontrollin Demokratik në Forcat e Armatosura" (DCAF). Realizimi i këtij projekti dhe finalizimi me një raport përfundimtar ka shërbyer si një instrument për të matur përgjegjëshmërinë dhe rezultatet në fushën e barazisë gjinore, parë në këndvështrimin e të drejtave të individit, femra dhe meshkuj, dhe do të shërbejë si një bazë fillestare për diskutime dhe planifikime të mëtejshme politikash. Studimi ka kaluar në katër faza kryesore: faza e parë: planifikimi për implementimin e projektit, janar-mars 2013; faza e dytë: grumbullimi i informacionit në terren, prill-maj 2013; faza e tretë: përpunimi dhe analiza e informacionit, qershor 2013 dhe faza e katërt: hartimi i raportit, korrik 2013. Gjatë realizimit të këtij projekti u intervistuan 48 persona, prej të cilëve 25 meshkuj dhe 23 femra, nga struktura të ndryshme në FA. Gjithashtu u zhvilluan 8 tryeza ku morën pjesë 110 persona, 53 meshkuj dhe 57 femra, të të gjitha gradave, si dhe personel civil nga MM dhe FA. Anketimet u përqendruan në çështje që prekin drejtpërdrejtë individët, siç janë: dhuna me bazë gjinore, ngacmimet seksuale, diskriminimi në punë, etj. Anketimet iu përgjigjën gjithsej 170 persona, 83 femra, 87 meshkuj duke përfshirë të gjitha gradat.

Homazh për intelektualin me ndikime në rrethet e qytetarisë elbasanase

Dy vjet pa Agim Dylgjerin, njeriun që i sherbeu kulturës

Nga Mujë BUCPAPAJ

Para dy vitesh, më 26 korrik 2010 ndërroi jetë intelektual i njohur, Prof. Agim Dylgjeri. Agimi lindi në Elbasan më 8 shkurt 1931 në një familje qytetare me tradita të thella atdhetare, si dhe me një kontribut të shquar në të gjitha levizjet kombëtare prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe në vazhdim. Baba i Agimit, Kamber Dylgjeri shquhej në zonën e Belshit dhe në të gjithë Dumrenë dhe Elbasanin për kontributin e tij si klerik i shquar dhe atdhetar. Miqtë e tij Lamçajt që në nga pronarët më të mëdhenj në Shqipëri, njerëz më lidhje të forta me perëndimin, jo vetëm për shkak të tregtisë, por edhe të mënyrës së jetës, shkollimit dhe koncepteve për lirinë, tregun dhe të ardhmen e vendit. Pavarësisht kontributit të tyre të vjetër për çështjen kombëtare, regjimi komunist do t'i shprononte Lamçajt, duke i pushkatuar, burgosur dhe internuar për gati 50 vjet me radhë. Ky persekutim la gjurmë të thella në formimin e Agimit si intelektual dhe njeri i lirëderi ditën e fundit të jetës.

Edhe pse ndërroi jetë pas një infarkti në zemër, Agimi mbetet i lidhur me botën, me qytetin dhe familjen e tij për shkak të zgjedhjes që kishte bërë, duke qënë një njeri i ekuilibrit dhe lirisë. Ai ishte një njeri i lirë dhe kurajoz. Prof. Agimi pas përfundimit të studimeve të larta si mësues, sherbeu me përkushtim gjatë gjithë jetës në Belsh dhe në Elbasan.

Agimi ka qënë një njeri human, i dashur me shokët, me studentët dhe komunitetin, prandaj dhe e thërrisnin me respekt dhe mirënjohje "Lalë Gimi."

Agim Dylgjeri ishte një intelektual sypatrembur. Ai i shprehu gjithmonë pikëpamjet dhe mendimet e tij pavarësisht nga çmimi, por me vendosmeri dhe forcë, pa përdorur arrogancë.

Mundi dhe djersa e tij ju shpërblyen me krijimin e një familje të shëndoshë, me 4 fëmijë të cilët do të bëheshin intelektualë të njohur në vend, fëmijë të cilët i rriti me bashkëshorten e tij të nderuar Lumnie, bijë e njëres prej familjeve më të shquara të Shqipërisë së Mesme.

Askush nuk do ta dijë fundin e tij, siç thuhet në librat e shenjtë "ditën e mbarme", por Agim Dylgjeri e pau atë duke shkuar i qetë në botën e amshueshme, pasi ishte i realizuar, si njeri, si intelektual si familjar dhe si një qytetar që u sherbeu deri ditën e fundit të jetës ideve të tij të lirisë, demokracisë, familjes dhe vendit.

Prof. Agimi ishte një intelektual zemërdhembshur. Agimi ishte një njeri që kishte dhjetra ha tokë, apo ullishta, si pronar i vjetër nga të gjitha degët e familjes, por kurrë nuk shkoi në dyert e gjykatave për t'i denoncuar ata që pas lindjes së plurazimit, apo edhe më parë, kishin ndertuar shtëpi, familje dhe të ardhme në ato hapsira. "Historia e lirisë, thoshte ai, është për të mbrojtur dhe jo për të përveçësuar, për të krijuar dhe jo për të abuzuar."

"Prof. Agim Dylgjeri u orintua në jetë me mençurinë e pagabueshme të tij, me vetëdijen e një ore të përhershme të përmbushjes së zotimit të një jete të gjatë dhe të ndershme. Ai ishte pjesë e historisë së një qyteti që rrezatoi me bujari prej shumë shekujsh kulturë dhe dije në të gjitha hapsirat shqiptare. Ai ishte një intelektual me interesa të gjëra, një njeri që e mbushi jetën dhe përjetësinë me qellime të medha dhe plot dinjitet. Si një ish-normalist tradicional, Agimi ishte letrar, gjuhëtarë, piktor, muzikant dhe instrumentist pasionant."

Kur e pyesnin shokët se pse nuk interesohej për pronat e familjes, ai pohonte se "emri i mirë vlen më shumë se thesarët." Në fakt ai la pas një emër të famshëm, pasi si të gjithë njerëzit e mirë ishte thellësisht i përkorrë.

Prof. Agimi si një intelektual i angazhuar nuk dyshoi kurrë tek liria dhe tek edukimi si proces i gjatë dhe me ndikim në formimin e njeriut, pavarësisht fatit që mund t'i kishte rezervuar jeta. Ai mendonte se "çdo njeri vlen se çdo njeri meriton një shans, se askush nuk ka lindur i parëndësishëm."

Ai tërë jetën luftoi që të forcoheshin shkollat, që tekstet e dobëta të hiqeshin nga qarkullimi, që ndryshimet sociale që erdhën pas levizjes së lirë, të mos shoqëroheshin me braktisjen e shkollës dhe rënjen e nivelit të cilësisë në zonat e thella dhe përfierike të vendit. Ai shkroi shumë artikuj për këto probleme tek gazeta "Nacional", por edhe në shtypin e Tiranës, duke marrë pjesë në shumë debate me këtë temë, si dhe përdorë lidhjet e veta miqësore me autoritet e larta të vendit për të inicuar reforma rrënjësore në arsim dhe kulturë.

Prof. Agim Dylgjeri, duke patur një formim patriotik punoi tërë jetën për një komb të bashkuar, të pasur në mundësi dhe drejtësi. Ngjarjen e 22 korrikut 2010, të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë e festoi në mënyrë solemne duke thënë se "tani Serbia i humbi të gjitha betejat me Kosovën dhe Shqiptarët." Edhe gjyshi edhe babi i tij, kishin punuar dhe luftuar për Kosovën, kishin kontribuar për Kosovën. Xhaxhai i tij Syrja Dylgjeri ishte deshmor i Luftës së Dytë Botërore. Ai vdiq si hero i vertetë duke luftuar me armë në dorë kundër pushtuesve italianë.

Agimi i ndiqte të gjitha lajmet për Kosovën nga njëri kanal në tjetrin, duke sygjerruar shpesh tema për shkrime të ndryshme në gazetën "Nacional" apo debate për Radio "Nacional" 93.3Mhz.

Për meritat e tij në shërbim të ar-

simit dhe kulturës shqiptare Prof. Agim Dylgjeri është dekoruar dy herë nga presidentët e Republikës më 1996 nga Presidenti Berisha dhe më 2002 nga Presidenti Moisiu. Ai ka marrë gjithashtu edhe plot mirënjohje nga Ministria e Arsimit, Kulturës, Organizata e veteranëve, etj.

Natyrisht, shërbimi i gjatë në arsim, kulturë dhe shkencë nuk mund të shperblehet kurrë, por kujtimi i njeriut të mirë është i pallogartishëm. Ai prin gjithnjë në rrugën e kontributit të lirisë dhe edukimit.

Agim Dylgjeri punonte me motivin se "jeta është e shkurtër, por mirësia dhe fisnikëria është e përjetshme."

Prof. Agimi ka qënë një veprimtar i shquar dhe i kudogjendur për zgjidhjen e halleve dhe problemeve të miqve, shokëve dhe komunitetit. Ai komunikonte gjithmonë me korrtëzinë e një "ambasadori" korrekt, por edhe me forcën e argumentit të një polemisti të lindur.

Agim Dylgjeri ka drejtuar për një kohë të gjatë dhe plot pasion e përkushtim organizatën e veteranëve demokratë të Elbasanit, duke qënë edhe anëtar i kryesisë Qendrore të këtij Institucioni, duke merituar besimin e të gjithëve.

Vdekjet e shokëve të tij i përjetonte me dhimbje të madhe. Shkruante për ta përherë tek gazeta "Nacional", por edhe në gazetën e Tiranës. Prandaj edhe Gjeneral Rrahman Parllaku, kryetar i OBVL-së, u shpreh ditën e varrimit se

"Vdekja e Agimit qe një humbje e madhe për familjen dhe fafesisin, shokët dhe veteranët."

Në shumë debate ai mendonte se detyrat më të medha të demokracisë kryehen nga gjithësecili dhe këtë parim përpiquej ta nguliste mirë tek çdo njeri. Ai luftoi gjithë jetën duke ju përmbajtur këtyre parimeve. Ai punoi me tërë fuqinë dhe ndikimin e vet të gjërë që çështjet e kulturës dhe arsimit, çështjet e edukimit në tërësi të merrnin vend kryesor në politikën kul-



ture të vendit, që ato të mbeteshin në qëndren e kujdesit të ditëve tona.

Prof. Agim Dylgjeri punoi që të gjithë në komunitet të ishin qytetarë të përgjegjshëm shërbimesh, për të ndertuar një brez të ri me karakter të fortë kombëtar me besim tek zoti dhe familja.

Agimi besonte tek zoti me fuqinë më të lartë dhe përlulen me të thellë. Ai mendonte se "nëse u përmbahemi besimeve, vuajtjet do të jenë më të lehta dhe veshtirësi më të kapërcyeshme."

Prej fillimit jeta mbetet një garë që mund ta humbasësh në çdo çast, që mund ta dështosh, si prej pavendosmerisë, thyerjeve të të dobtëve, apo fatit të keq, por gjithnjë ka njerëz që e kanë fituar këtë garë dhe njeri prej tyre ishte edhe Prof. Agim Dylgjeri.

Ai ishte një intelektual me interesa të gjëra, një njeri që e mbushi jetën dhe përjetësinë me qellime të medha dhe plot dinjitet. Si një ish-normalist tradicional, Agimi ishte letrar, gjuhëtar, piktor, muzikant dhe instrumentist pasionant.

Prof. Agimi e vazhdoi këtë angazhim intelektual pandërprerë edhe pse problemet e zemrës erdhën duke ju shtuar këto vitet e fundit. Ai luftoi për ta bërë jetën e familjes së tij më të mirë, vendin tonë më të drejtë dhe më bujar, për të pohuar dinjitetin e jetës tonë dhe të çdo njeriu.

Ai pa u lodhur asnjëherë, po u dorëzuar asnjëherë e vazhdoi angazhimin e tij deri pak çaste para se të mbyllte sytë mes fëmijëve, graas, nipërve dhe mbesave të dashura e që e shinin Gjyshin e tyre si "Plakun e përrallave" të Vitit të Ri, që bënte

vetëm mrekullira dhe bamirësi.

Ai u orintua në jetë me mençurinë e pagabueshme të tij, me vetëdijen e një ore të përhershme të përmbushjes së zotimit të një jete të gjatë dhe të ndershme. Prof. Agim Dylgjeri ishte pjesë e historisë së një qyteti që rrezatoi me bujari prej shumë shekujsh kulturë dhe dije në të gjithë hapsirat shqiptare.

Prof. Agim Dylgjeri edukoi breza të tërë studentësh me përkushtim ndaj lirisë dhe kundërshtimit të urrjetjes, me ndjenjen e pandërprerë ndaj familjes dhe vendit. Ai kishte besim të patundur se "shpresat shperblehen dhe forca e të drejtës fiton."

Prof. Agim Dylgjeri u thoshte studentëve të tij se duhet të punojmë pareshtur, që me këmbëngulje dhe besim të bëjmë gjithmonë zgjedhje të moralshme.

Ai deklaronte se nuk mund të ketë drejtësi pa liri, as nuk mund të ketë të drejta njerëzore pa liri njerëzore, se kurrë nuk duhet jetuar në meshiren e askujt, aq më pak të diktatorëve, tiranëve, shtypësve të lirisë.

Bashkohësit e Agim Dylgjerit e nderuan miqësinë e tij, i respektuan këshillat dhe ndihmën e tij, duke i bërë përcjelljen më kuptimplotë për në banesën e fundit. Prof. Dylgjeri deklaronte pandërprerë se veprat tona na ndjekin pas si një proces që gjykon njerëzit dhe krejt botën pa meshirë dhe pa përzgjedhje.

Kjo punë vazhdon, kjo ëndërr vazhdon. Agimi ka lënë djemtë, vajzat, nipat dhe mbesat e dashura që do të çojnë më tej filozofinë e tij përmes një stuhie të gjatë dhe shpesh të egër, që quhet jetë.

Oto Skorseni dhe zbulimi gjerman

Nga Elvis Kotini

Oto Skorseni (12 June 1908 - 5 July 1975): Ishte një lejtënantkolonel "SS" në trupat luftarake gjermane "SS", gjatë Luftës II Botërore. Pasi luftoi në frontin perëndimor, ai u zgjodh si komandant i fushës për të kryer misionin e shpëtimit që do të lironte diktatorin e mbajtur italian Benito Musolini nga zënia rob. Skorseni ishte gjithashtu udhëheqësi i operacionit "Greif", në të cilin ushtarët gjermanë ishin infiltruar përmes linjave të armikut, duke përdorur gjuhë të ndryshme, uniforma, dhe veshje. Në përfundim të luftës, Skorseni u përfshi në lëvizjen guerile "Eeröolf" dhe rrjetin "Odesa", ku do të shërbente si koordinator spanjoll. Megjithatë ai ishte akuzuar për shkeljen e klauzolës 1907 të Konventës së Hagës në lidhje me operacionin "Greif" gjykata ushtarake e Dakaut e liroi Skorsenin pas lufte nga kjo akuzë. Skorseni doli nga mbajtja në burg në vitin 1948, dhe shkoi fillimisht në Francë, dhe më pas në Spanjë. Ai lindi në Vjenë në një klasë të mesme austriake me rrënjë polake. Me gjithë kombësinë gjermane, ai fliste shkëlqyeshëm frëngjisht. Në vitin 1931, Skorseni u bashkua me Partinë Naziste Austriake dhe shpejt u bë anëtar i trupave luftarake naziste. Një figurë karizmatike, Skorseni luajti një rol të vogël në Anshlus më 12 mars 1938, kur ai shpëtoi presidentin austriak Miklas nga pushtatimi i nazistëve austriakë. Pas pushtimit të vitit 1939 të Polonisë, Skorseni, asokohe punonte si një inxhinier civil, doli vullnetar mbi shërbimin në forcat ajrore gjermane, por u kthye mbrapsht sepse ishte konsideruar shumë i gjatë, dhe shumë i vjetër, për ekuipazhin ajror të trajnimit. Ai u bashkua me regjimentin e rojës së Hitlerit si një oficer kadet. Në vitin 1940, si një lejtënant i kategorisë së dytë "SS", ai i impresionoi superiorët duke projektuar se si të ngarkonte tanket në drejtim të anijeve të transportit. Ai në atë kohë luftoi në Holandë, Francë, dhe Ballkan, ku ai u shqua se detyroi një forcë të madhe jugosllavësh që të dorëzoheshin dhe më pas u promovua si lejtënant i parë, në trupat "SS". Skorseni shkoi në luftë në Bashkimin Sovjetik me Divizionin II Pancer "SS" "Das Reich" dhe për rrjedhojë luftoi në shumë beteja, në frontin lindor. Në vitin 1941 ai u ngarkua me "seksionin teknik" të forcave gjermane gjatë betejës së Moskës. Në vitin 1942, Skorseni u godit në pjesën e prapme të kokës nga "Kanjusha" sovjetike. Ai refuzoi ndihmën e parë përveçse pak aspirinave dhe një gote me shnaps. Pak orë më vonë, Skorseni u bashkua me njësinë e tij, por shëndeti i tij precipitoi dhe dhimbje të vazhdueshme të kokës dhe stomakut e detyruan atë të evakonte nga trajtimi i përshtatshëm mjekësor. Ai u vlerësua me Kryqin e Hekurit për Trimëri nën Zjarr dhe u mikprit në Vjenë. Ndërsa ishte në rikuperim nga plagët e tij atij iu dha një rol stafi në Berlin, ku ai lexoi të gjithë literaturën që mund të gjendej mbi komandot dhe gjendjen e luftimit, dhe çoi përpara në një komandë më të lartë ide të tij mbi situatën komando jo kon-

vecionale. Propozimet e Skorsenit ishin që të zhvilloste njësi të specializuara në situata të tilla jo konvencionale, duke përfshirë partizanë të ngjashëm që të luftonin thellë pranë linjave të armikut, duke luftuar në uniformën e armikut, sulme sabotazhe etj. Në vitin 1943, emri i Skorsenit u çua më lart nga Ernst Kaltenbrenner, koka e re e RSHA-se dhe Skorseni u takua me Drejtuesin e Brigadës "SS", kokën e armatës VI Ausland SD (inteligjenca e jashtme e SS në departamentin RSHA). Ky caktoi Skorsenin me komandën e shkollave për të organizuar trajtimin e operacioneve në sabotazh, spiunazh, dhe teknikat paramilitare. Skorseni u emërua komandant i trupave të mëparshme të luftimit të vendndodhura afër Berlinit. Operacioni "Francois" e gjeti Skorsenin duke dërguar një grup parashutistësh në Iran për të mbajtur kontakte me disidentët e fiseve alpine për të inkurajuar ata që të sabotonin pajisjet e aleatëve dhe materialet që dërgoheshin në Bashkimin Sovjetik përmes stacionit trans-iranian. Megjithatë përpjekjet midis fiseve rebele ishin të dyshimta dhe operacioni "Francois" u konsiderua një dështim.

Lirimi i Musolini

Në korrik 1943, ai ishte zgjedhur personalisht nga Hitler prej gjashtë gjermanëve të forcave ajrore dhe agjentëve specialë të ushtrisë gjer-



mane për të udhëhequr operacionin e shpëtimit të diktatorit italian Musolini, i cili ishte burgosur nga qeveria italiane. Musolini fillimisht mbahej në vilën e La Madalenës afër Sardenjës. Skorseni kaloi një komando italisht folëse brenda ishullit dhe pak ditë më vonë ai konfirmoi që Musolini ishte në vilë. Skorseni fluturoi ndërkaq me një Heinkel He 111, për të marrë foto ajrore mbi vendndodhjen. Bomberi gjerman u godit nga gjuajtës aleatë dhe ra në det, por Skorseni dhe ekuipazhi u shpëtuan nga destroyerët italianë. Musolini u transferua së shpejti pas kësaj. Informacionet mbi vendndodhjen e re të Musolinit dhe pasjeve të tij tipografike u siguruan më në fund nga Herbert Kapler. Kapler raportoi se Musolini mbahej në hotelin e perandorit Kampe në majën e malit Gran Sasso. Skorseni fluturoi rishtazi mbi Gran Sasso dhe mori fotografi mbi vendndodhjen e mbuluar me kamera. Një plan sulmi u formulua nga gjeneral Kurt Student, Harlad Mors dhe Skorseni. Në 12 shtator, operacioni u përbush në mënyrë perfekte si-

pas planit, dhe Musolini u shpëtua pa pasur asnjë qitje. Duke fluturuar në një aeroplan "Storch" Skorseni dërgoi Musolinin në Romë fillimisht dhe më vonë në Berlin. Musolini krijoi një regjim të ri fashist në Italinë e Veriut (Republika Sociale Italiane).

Operacioni "Long Jump"

Operacioni ishte emri i kodifikuar i dhënë për një komplot për të vrarë "Big Three" (tre të mëdhenjtë) Stalin, Çurcill dhe Ruzvelt në vitin 1943, në Konferencën e Teheranit. Hitleri supozohej të kishte dhe në komandën e operacionit Ernst Kaltebrunner, shefi i RSHA-së, i cili në kthim i dha misionin Skorsenit.

Operacioni "Rosselsprung"

I njohur për rrjedhojë si "Sulmi mbi Drvar". Ky ishte një operacion komando për të kapur shef komandantin jugosllav mareshalin Josif Tito, i cili ishte njohur së fundmi nga aleatët si kryeministri jugosllav.

Komploti kundër Hitlerit

20 korrik. Skorseni ishte në Berlin kur një përpjekje kundër jetës së Hitlerit ishte realizuar. Oficerë antinazistë gjermanë u përpoqën për të kryer kontrollin e vendimeve më të rëndësishme të Gjermanisë, para se Hitleri të shërohej nga plagët e marra. Skorseni ndihmoi të sprapste rebelimin, duke kaluar 36 orë i ngarkuar më punë në qendrën e komandës në Vermahtit, para se të ngrihej nga kjo detyrë. Ai arriti në Benderblock, vetëm 30 minuta pasi Klaus fon Staufenberg dhe bashkëpunëtorët e tjerë të rëndësishëm të ekzekutoheshin sipas urdhrit.

Operacioni "Greif"

I planizuar nga Skorseni përfshiu rreth një duzinë ushtarësh gjermanë, shumë nga të cilët kishin marrë xhupa amerikanë dhe veshje të ushtarëve amerikanë, të cilat do të depërtonin në linjat amerikane në orët e para të betejës së Bulgeand, për të shkaktuar çrregullime dhe konfuzion pranë linjave të aleatëve. Një pjesë e njerëzve të tij që ishin zënë rob, kishin përhapur zhurmën që Skorseni personalisht kishte marrë në dorë drejtimin e sulmit për të vrarë ose zënë rob gjeneral Ajzenhauer. Për këtë arsye gjenerali shpërndau postera "ëantë" përmes territoreve të kontrolluara aleate me tiparet dhe përshkrimin e detajuar të fotografisë. Nga 23 njerëzit e Skorsenit të zënë rob, 18 prej tyre u ekzekutuan për kundërshtime të ligjeve të luftës se kishin veshur uniforma të armikut.

Pas lufte

Skorseni u mbajt si i burgosur lufte për më shumë se dy vjet para se të dërgohej në gjyq si kriminel lufte në Gjykatën e Dakaut në vitin 1947 për thyerjen të ligjeve të luftës në betejë. Ai dhe oficerët e brigadës "Panzer 150" u akuzuan se në mënyrë të papërshtatshme kishin përdorur uniforma amerikane për t'u infiltruar në linjat amerikane.

Lindja e Mesme

Skorseni kaloi gjithashtu një kohë në Egjipt. Në vitin 1952, vendi ishte marrë nën kontrollin e gjeneralit Mohamed Naguib. Skorseni u dërgua në Egjipt nga gjenerali Reinhard Gehlen, i cili tashmë punonte për CIA, dhe për



të vepruar si këshilltar ushtarak i Naguib. Skorseni rekrutoi një staf të përbërë nga ish oficerë "SS" për të trajnuar ushtrinë egjiptiane. Më vonë Skorseni i ofroi shërbim inteligjencë Mosadit, si shërbimi i jashtëm inteligjent i Izraelit mbi punën e ish shkencëtarëve nazistë që punonin në qeverinë egjiptiane. Skorseni ra dakord që të bashkëpunonte me Izraelin më kusht që të fshihej emri i tij nga lista e të kërkuarve për krime të nazizmit dhe arresti ndaj tij të anulohet. Si shumë prej ish nazistëve Skorseni u deklarua i denazifikuar në mungesë në vitin 1952, nga një bord arbitrazhi qeveritar gjermano-perëndimor çfarë do të thoshte se tani ai mund të udhëtonte prej Spanjës në vendet perëndimore me një pasaportë speciale me të cilën ai vizitoi Irlandën në vitin 1957 dhe 1958. Në vitin 1958 ai u kualifikua me një pasaportë austriake dhe në vitin 1959, ai bleu shtëpi në Martinstoën, 165 km/2, në fermën Kildare. Sidoqoftë Skorseni refuzoi vizën rezidente nga qeveria irlandeze dhe kufizoi qëndrimin e tij në gjashtë javë, gjatë të cilave ai u monitorua nga G2. Skorseni kishte gjithashtu prona në Majorjka.

Vdekja

Në vitin 1970 një tumor kancer u zbulua në shtyllën kurrizore të Skorsenit. Dy tumore u zhvendosën në Hamburg, por që ndërhyrja e la atë të paralizuar nga mesi e poshtë. Skorseni në fund vdiq nga kanceri në 5 korrik 1975 në Madrid. Ishte 67 vjeç dhe iu krye një funeral katolik, por më vonë u krematorua dhe eshtrat e tij u dërguan në Vjenë pranë familjes.

Konkluzione

Kush është ky njeri! A përfaqëson dinamikën e luftës? Përse u cilësua nga aleatët "njeriu më i rrezikshëm në Europë"? Menjëherë pas shpëtimit të Musolinit, Hitler, telefonon në hotel në Berlin, Skorsenin duke i dhënë gradën e majorit. Por rasti i shpëtimit nuk ishte i vetmi për Skorsenin. Ai shpëtoi me një gjakftohtësi presidentin austriak nga vrasja e sigurt prej nazistëve. Tregon profesionalizëm dhe dituri. Një student i dekoruar, që do ta shoqëronin më pas shumë dekorata dhe vlerësime nga elita e ushtrisë gjermane. Një nga njerëzit e preferuar të Hitlerit, madje në urdhra direkt të operacioneve më të komplikuar tregojnë një Skorseni "SS" model

për ushtrinë gjermane. I respektuar për legjendën e tij luftarake dhe suksesin e operacioneve, numrin më të madh të arritur të tyre, që nga fronti deri në luftimet direkte. Siç e pamë "autopsinë" e komandos "SS" Skorsenin, bëhet fjalë për një talent të zbulimt botëror, i provuar në terren dhe një karakteristikë e njohur dyplanëshe: Antanta dhe Boshti Qendror. Telat e luftimit nuk na japin parfytyrimin e një kriminelit të luftës, pasi ai u mbajt shumë pak nën akuzë, sepse dihet në kësi rastesh se përgjegjësia juridike bie me vprimin ushtarak. Aleatet gabojnë kur akuzojnë më "krime në betejë" Skorsenin, nën uniforma të armikut, pasi termi "betejë" është i papërcaktuar". Skorseni ishte jo vetëm njohës i mirë i taktikës luftarake, por edhe një zbatues i saktë i ndjenjës së dyshimit praktik. Skorseni pajiset me shumë pasaporta, ç'ka është normale për periudhën politike të pas luftës dhe gjetjen e një identiteti të rregullt zyrtar. Vetë gjeneralët e pas luftës e implikuan Skorsenin në misionin seri. Që nga Egjipti, deri në Argentinë me Evita Peron, që nga themelimi i CIA (1947) me Donovan e deri në elitën e zbulimit botëror. Jetoj dhe punoi pjesën tjetër të jetës nën shoqërinë e ngushtë të Frankos në Spanjë, duke pasur miliona nga pasuritë e ndërtimeve. A duhej akuzuar Skorseni për vrasjen e Kenedit në vitin 1962? Një alibi që u ngrit nga zërat e shërbimeve për implikimin e nazistëve në këtë vrasje. Por që fakti i goditjes trunore të presidentit nuk shpjegon më shumë sesa vdekjen e tij klinike. Grada e majorit në ushtri është nyja lidhëse e informacionit ushtarak dhe funksioni operativ i një komandoje "SS" gjatë luftës përbën një shembull për tu ndjekur në fushën e zbulimit dhe analizës. Ishin këto disa të dhëna historike për elitën e zbulimit botëror Oto Skorseni edhe si një shembull profesional mbi ecurinë e shteteve në drejtime të qarta evoluimi, duke lënë pas paranojën e sistemeve me motivin se arti politik është edhe art luftarak. Këtë mesazh të shkëlqyer në kohë paqe dhe lufte e gjejmë tek ky nazist "SS" austriak në përmbajtje të të cilit ishte liria e veprimit ushtarak pa cenuar asnjë klauzolë civile.

(P.s: *Materialet kryesore janë marrë nga libri "internet.com" mbi të drejtën e autorit dhe burimin e informacionit zyrtar.*)

Ban Ki Moon: Marrëveshja në Veri mbetet sfida kryesore

Në raportin e tij më të fundit mbi zhvillimet tremujore në Kosovë, raport që iu dha RTK-së nga burime në Neë York, Sekretari i Përgjithshëm i OKB, Ban Ki Moon, i vlerëson hapat pozitivë të ndërmarrë nga Prishtina dhe Beogradi që çuan "në marrëveshjet historike dhe në një progres fundamental drejt normalizimit të marrëdhënieve". Ai përgëzon udhëheqjet politike në Prishtinë dhe Beograd që treguan siç thotë "angazhim serioz dhe të palëkundur gjatë dialogut". "Zbatimi i marrëveshjeve midis Beogradit dhe Prishtinës në Veri të Kosovës mbetet një sfidë kryesore", shkruan Sekretari Ban për të shtuar se, "në këtë drejtim angazhimi i Beogradit me serbët e Kosovës mbetet i rëndësishëm". Ai thotë se këto përpjekje "duhet të plotësohet me shtrirje të

dorës nga ana e Prishtinës, duke i ofruar siguri popullsisë lokale". Në mënyrë që të shmangen tensionet dhe arrihet sukses, Ban thotë se është e rëndësishme që "edhe serbët lokalë të Kosovës ta shohin veten si palë e interesuar në proces". "Trashëgimitë e pazgjidhura të konfliktit, përfshirë edhe rastet e pazgjidhura të personave të zhdukur, si dhe sjellja para drejtësisë e të gjithë atyre që janë përgjegjës për krime të luftës dhe vepra të tjera penale, duhet të mbeten prioritet kyçe", thuhet në raportin mbi Kosovën të sekretarit Ban Ki Moon që përfshin një periudhë të zhvillimeve prej 23 prillit deri më 15 korrik. Raporti do të shqyrtohet në një seancë të veçantë të Këshillit të Sigurimit më 29 gusht nën kryesimin e Argentinës, takim ku pritet të mar-

rin pjesë edhe Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Ivica Dačić.

Zgjedhjet edhe në Veri, me ligje të Kosovës

Në zgjedhjet e nëntorit, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të kërkojë vota edhe në Veri të Mitrovicës, por e kanë të qartë se tashmë atje ka pak votues shqiptarë. Kreu i kësaj partie e ka konfirmuar këtë, por nuk ka saktësuar nëse do të kërkojë vota edhe në tri komunat serbe në atë pjesë, megjithatë ai ka pohuar se zgjedhjet edhe në atë pjesë të vendit, e dinë se do të mbahen me ligje të Kosovës. Këto komente, Ramush Haradinaj i ka bërë pas takimit që kishte me shefin e misionit të OSBE-së në Qen-



drën për Parandalimin e Konflikteteve, Pascal Heyman, me të cilin biseduan për zgjedhjet e veçanërisht për ato në Veri. U tha se nuk u fol për ndonjë lloj konflikti. Haradinaj

ka komentuar edhe kërkesën e serbëve që të mos ketë simbole të Kosovës në fletëvotime, duke thënë se duhet të gjendet një zgjidhje kreative.

Piramida ushqimore, çfarë dhe sa duhet të hamë?

Sa herë mund të tundoheni gjatë ditës kur bëhet fjalë për ushqimin? Dëshironi të hani dhe provoni gjithçka. Por ka një piramidë që na tregon se çfarë duhet të konsumojmë më tepër dhe sa duhet të hamë. Njihuni me të ...

Ëmbëlsirat e shëndetshme

Sa duhen konsumuar? 30 gramë, 2 - 3 herë në javë.

Zgjedhjet e duhura: Fruta të thata, çokolatë e zezë, mjaltë, si dhe akulllore me fruta.

Pse kjo zgjedhje: Sepse çokollata e zezë është një oksidant i mirë. Zgjidhni çokollatën e zezë me të paktën 70 për qind kakao dhe konsumoni 30 gram në javë. Është sasia që duhet konsumuar çdo javë. Edhe akullorja me fruta është një nga ëmbëlsirat më të mira, e cila nuk përmban shumë kalori.

Vera e kuqe

Sa duhet konsumuar? Jo më tepër se 1-2 gota në ditë.

Zgjedhja më e mirë: Vera e kuqe e vjetër.

Pse: Vera e kuqe ka efekte antioksidante për organizmin, të cilën duhet ta konsumoni vetëm nëse jeni përdorues të alkoolit, në të kundërt mos e filloni.

Çaji

Sa shumë: 2-4 filxhanë në ditë. Zgjedhja më e mirë: Çaji normal, jeshil, si dhe çaji i gjatë.

Pse kjo zgjedhje: Sepse çaji jeshil është pija e pasur me katekinë dhe oksidantë të tjerë. Blini çajin më të mirë dhe përdoreni në vakte të ndryshme të ditës.

Erëzat e shëndetshme

Sa shumë: Pa limit.

Zgjedhjet e mirë: Xhenxhefil,

hudhra të thata dhe me rrënjë, piper, piper djegës, kanellë, rozmarinë, trumzë, apo borzilok.

Përse: Përdorini këto lloj erëzash dhe lulësh, lirshëm në kombinime të ndryshme gatimesh. Xhenxhefili dhe hudhrat janë agjentë të fortë anti-inflamatorë.

Proteina të tjera

Sa herë: 2 -3 herë në javë.

30 gramë djathë.

Një vezë në ditë.

Shpendë të gatuar deri në 90 gramë.

Zgjedhjet e shëndetshme: Djathëra natyralë, ushqime të tjera proteinike të pasura me omega-3, dhe nëse mundeni konsumoni mish shpendësh pa lëkurë.

Përse: Në përgjithësi për të pasur një dietë sa më të rregullt dhe të shëndetshme duhet reduktuar sasia e produkteve që vijnë nga mish i kafshëve.

Nëse hani mish pule, zgjidhni pulë të freskët, së cilës duhet t'ia hiqni lëkurën. Edhe vezët duhet të jenë sa më të freskëta, mundësisht vezë fshati.

Kërpudhat

Sa shumë: Pa limit.

Përse: Këto lloj kërpudhash janë të veçanta dhe ndryshojnë nga të tjerat për vlerat që kanë. Ato kanë në përmbajtjen e tyre substanca që përmirësojnë sistemin imunitar. Asnjëherë mos hani kërpudha të ziera, dhe minimizoni konsumin e atyre të konservuara.

Peshk dhe fruta deti

Sa shumë: 2 -6 racione në javë.

Një racion me peshk si dhe fruta deti - duhet të ketë 120 gramë.

Zgjedhja më e mirë: Peshk trofte, salmon, harengë, si dhe sardele.

Pse: Këta lloj peshqish janë tepër të pasur në omega-3, që i bëjnë mirë organizmit. Nëse nuk dëshironi të hani peshk, konsumoni vaj peshku, të paktën deri në 2-3 gram vaj peshku në ditë.

Pasta (të gatuar edhe "al dente") Sa shumë: 2-3 racione në javë.

Një racion duhet të jetë një garuzhde e plotë e gatuar.

Zgjedhjet e mirë: Makaronat që bëhen nga mielli i trashë që nuk kanë përmbajtje veze, ose pasta jo të bëra më parë në formë pete.

Pse: Sepse pasta e gatuar në mënyrë "al dente" ka një nivel më të ulët të glicemisë se pasta e gatuar plotësisht, e cila nuk lejon një qarkullim shumë të mirë të gjakut, që është primare për një aktivitet harmonik të pankreasit.

Fasulet dhe bizelet

Sa: 1-2 racione në ditë.

Një racion duhet të jetë një garuzhde jo e plotë.

Zgjedhjet e mirë: Fasule e zezë dhe e kuqe, thjerrëza dhe bizele.

Pse: Sepse fasulet janë të pasura me acid folik, magnezium, fibër, si dhe kanë nivel të ulët të glicemisë.

Perimet

Sa shumë: Minimumi 4-5 racione në ditë.

Një racion është një garuzhde.

Zgjedhjet e mirë: Perime të gatuar sa më pak, si (spinaq, lakër, brokol, lulëlakër,) karota, panxhar, qepë, bizele, si dhe lakër e zier.

Pse: Sepse perimet janë të pasura me flavonoide dhe karotenoide.

Frutat

Sa shumë: 3-4 racione në ditë.

Një racion duhet të ketë një filxhan me fruta të shtrydhura.

Zgjedhjet e shëndetshme: Mana-



Çokollata e zezë është një oksidant i mirë. Zgjidhni çokollatën e zezë me të paktën 70 për qind kakao dhe konsumoni 30 gram në javë. Është sasia që duhet konsumuar çdo javë. Edhe akullorja me fruta është një nga ëmbëlsirat më të mira, e cila nuk përmban shumë kalori

ferrë, boronicë, lulështrydhe, pjeshkë, portokall, rrush, kumbulla, shegë, qersh, mollë dhe dardhë.

Pse: Frutat janë më se të domosdoshme për organizmin. Ashtu si perimet edhe ato janë të pasura me flavonoide dhe karotenoide, si dhe me antioksidantë natyralë.

Ujë

Sa: Gjatë gjithë ditës

Zgjedhja më e mirë: Konsumoni ujë të purifikuar ose pije të bëra me ujë të purifikuar, si për shembull çaj pa sheqer ose pije të bëra vetë nga shtrydhja e frutave.